Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës, 05 nr. 350/02 - 0202511/18 dt.17.08.2018, të pronarit, Tafil Osmani nga Gjakova, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa– Lam. "1" me dëstinim për banim dhe afarizëm, me etazhitet B+S+P+14, Hoteli me etazhitet B+S+P+14, ndërtesa me destinim për afarizëm me etazhitet S+P, dhe ndërtesa me destinim për garazhe me etazhitet –B+S, në kuadër të Bllokut urban "F-4-1", të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me datë 30.11.2018, merr këtë:

## VENDIM
## PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I caktohen kushtet ndërtimore** pronarit, Tafil Osmani nga Gjakova, sipas kërkesës 05 nr. 350/02 - 0202511/18 dt.17.08.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa – Lam. "1" me dëstinim për banim dhe afarizëm, me etazhitet B+S+P+14, Hoteli me etazhitet B+S+P+14, ndërtesa me destinim për afarizëm me etazhitet S+P, dhe ndërtesa me destinim për garazhe me etazhitet –B+S, në kuadër të Bllokut urban "F-4-1", të Planit Rregullues " Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në parcelat ndërtimore formuar nga parcelat kadastrale, nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë, si dhe me trajtim përmes këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale, nr. 356-1 ZK Prishtinë, me pronar / posedues Tafil Osmani nga Gjakova, me pjesët e parcelave kadastrale, nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët".

**II. Lokacioni** për të cilin caktohen kushtet ndërtimore përfshihet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e KK Prishtinë 01. Nr. 035-186833, më 02.10.203, ku sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar "Mikse".

Për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, kërkuesit janë informuar përmes "Informim nga Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" me referencë nr. 05-350/01-0112086/17 dt.14.02.2017, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja ekzistuese** e lokacionit / parcelave, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:

| | | | |
|---|---|---|---|
| - nr.356-1; | S=6135m²; | Tafil Osmani; | "Arë e klasës 5"; |
| - nr.353-3; | S=5293m²; | Tafil Osmani; | "Arë e klasës 5"; |
| - nr.354-2; | S=276m²; | Tafil Osmani; | "Infrastrkturë – rrugë e pa koategorizuar"; |

**Totali i parcelave: S=11704m²;**

- Parcelat kadastrale, nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë, janë në pronësi të pronarëve private, gjegjësisht e drejta pronësoro - juridike është private - tokë e ndërtuar, me kyçje në infrastrukturë teknike rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe telefoni, kurse parcelat kadastrale nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët".
- Në kuadër të parcelave kadastrale, , nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë ZK Prishtinë, nuk ekzistojnë ndërtesa;
- Terreni i lokacionit të parcelave nr. , nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë, ka pjerrtësi nga drejtimin jug në drejtimin veri-jug, me disnivel ~2.0m' dhe drejtimin lindje-perëndim, me disnivel ~4.0m';
- Në diametër prej 50m' të lokacionit, përfshihen kryesisht ndërtesa shumëbanesore, si dhe qendra tregtare "Albi Mall";

- Parcelat kadastrale të lartcekura, kanë qasje në rrugën, "Richard Holbrooke", e cila rrugë është edhe rrugë e planifikuar nga plani rregullues urban;

**IV. Plani i situacionit** – "zgjidhja urbane" e Kompleksi me ndërtes shumë banesore & afariste, dhe hoteli, e analizuar, studiuar & trajtuar është konceptuar të realizohet si tërësi, me trajtim dhe analiza të parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale, nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë dhe si dhe këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 356-1 ZK Prishtinë, në pronësi të Tafil Osmani nga Prishtina, me pjesët e parcelave kadastrale nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët".

**V. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin/ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam."1" dhe "hoteli", si dhe hapësirat përcjellëse, në kuadër të parcelës ndërtimore të Bllokut urban "F-4-1", të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", bazuar në kriteret & parametrat urban të planit, dhe ato janë:

- Organizimi, gabariti, pozicionimi, etazhiteti i ndërtesave dhe raporti i tyre me vijën rregulluese dhe ndërtimore dhe distancat nga kufiri i parcelave, rrugët e planifikuara, parcela ndërtimore e bllokut urban, si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", bashkëngjitur vendimit të kushteve ndërtimore;
- Pjesët & parcelat kadastrale, me sipërfaqen të trajtuara, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. "1" me dëstinim për banim dhe afarizëm, Hoteli, ndërtesa me destinim për afarëm, dhe ndërtesa me destinim për garazhë, konkretisht parcelat të përfshira në ndërtim – <u>brenda vijës rregulluese me këtë fazë</u>, janë:
  - nr. 354-2; S=276m²; Tafil Osmani
  - nr. 355-3; S=4903m²; Tafil Osmani
  - nr.356-1; S=3856m²; Tafil Osmani
  - nr. 353-0; S=268m²; P.Sh. K. Komunal
  - nr. 354-1; S=522m²; P.Sh. "rrugët"
  - nr. 355-4; S=668m²; P.Sh. "rrugët"

  <u>Totali S=10493m²</u>
- Pjesët & parcelat kadastrale me sipërfaqe të trajtuara, për realizimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. "1" me dëstinim për banim dhe afarizëm, Hoteli, ndërtesa me destinim për afarëm, dhe ndërtesa me destinim për garazhë, që shtrihen në hapësira publike të planifikuara, konkretisht që shtrihen <u>jashtë vijës rregulluese</u>, janë:
  - nr. 355-3; S=390m²; Tafil Osmani
  - nr.356-1; S=1478m²; Tafil Osmani

  <u>Totali: S=1868m²</u>
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të kompleksit, planifikohet ndërtimi i Kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste – Lam. "1" me dëstinim për banim dhe afarizëm, Hoteli, ndërtesa me destinim për afarëm, dhe ndërtesa me destinim për garazhe, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet (sipas projekt propozimit):

**Ndërtesë shumë banesore;**
**Lam. "1" - S=16028.70m²** / 15711.45m², mbi tokë + 317.25m²,nën tokë /,
Etazhitet: **-B + S + P + 14**
**Hoteli - S=14355.00m²** / 12760m², mbi tokë + 1595m², nën tokë /,
Etazhitet: **-B + S + P + 14**
**Ndërtesa afariste - S=3124.30m²** / 2519.30m², mbi tokë + 605m²,nën tokë /,
Etazhitet: **S+P**
**Ndërtesa Garazhuese - S=8468.20m²** / 1634.10m², mbi tokë + 6834.10m²,nën tokë /,
Etazhitet: **-B+S**
**Totali: Lam. "1"+Hoteli+Ndërtesa Afariste dhe Ndërtesa Garazhuese - S=41976.20m²** / 32624.85m²,mbi tokë + 9351.35m², nën tokë /.

- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë "Ndërtim i lartë ", gjegjësisht banim shumë banesor & afarizëm, dhe hotel, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhuese (sipas projekt propozimit të prezantuar);
- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelave të bashkuara në kompleks (ISHP), brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të përdheses ose suterenit – etazhat e para, lejohet max.40%, dhe kjo sipërfaqe është:

S= 10493.00 x 0.4 = 4197.20m² / lejuar sipas planit rregulluese për prona private /,
S=4170.00m² / sipas projekt propozimit /.


Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosove
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Koeficienti i shfrytëzimit i parcelave të bashkuara në kompleks (ISHP), brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në kate - gabarit të kateve – etazhat e tjera, lejohet max. 25%, dhe kjo sipërfaqe është:
S= 10493 x 0.25 = 2623.25m² / lejuar sipas planit rregulluese për prona private /,

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave të bashkuara në kompleks për nëntokë (ISHPN) për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, lejohet max. 60% dhe bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr. 031–185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, kjo sipërfaqe është:
S=10493 x 0.6 =6295.80m² / lejuar sipas vendimit për pronat private /,
S=6286.50m² / sipas projekt propozimit /.
- Në kuadër të kompleksit - parcelës ndërtimore, të planifikohet sipërfaqe gjelbëruese (me gjelbërim të lartë & ultë) dhe absorbuese 20%, e organizuar për sport dhe rekreacion, bazuar në planin rregullues, normat teknike të planifikimit hapësinor dhe paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 nr. 031–185481 dt. 14.08.2015, ku kjo sipërfaqe për kompleksin e bllokut, është;
S=10493 x 0.20 = 2098.60m²,/lejuar për parcela private/
- Koeficienti i ndërtimit (ISHN) bazuar në sipërfaqen e parcelës ndërtimore, lejohet të jetë max.3.0. Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: ***100%*** për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi ***51%*** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - ***suteren***, dhe ***0%*** për etazhet e nëntokës – ***bodrum***, dhe kjo sipërfaqe është:

**A**: S=9035 x 3.0 = 27105m² / lejuar për parcela private brenda vijës rregullues /,
**B**: S=1458 x 3.0 =4374m² / lejuar për parcelat për këmbim/

Pasi që sipërfaqja totale e parcelave kadastrale, nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët", është S=1458m², atëherë nga pjesa sipërfaqja e parcelës kadastrale nr. 356-1 ZK Prishtinë, të përfshirë në rrugë të planifikuar prej 1458 m² (në pronësi të Tafil Osmani-it), do të këmbehet me parcelat kadastrale nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, ndërsa diferenca prej 20m² do të trajtohet me aplikimin e Vendimit 01 nr. 400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private, përfshirë në hapësira me interes publik me koeficient të ndërtimit, sipërfaqja jashtë parcelës ndërtimore-vijës rregulluese të Blloku urban "F-4-1", , do të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore prej

**C**: Pjesa e parcelës kadastrale nr. 356-1 ZK Prishtinë, me sipërfaqe prej 20m² x 3.0 = 60m²
**D**: Pjesa e parcelës kadastrale nr. 355-3 ZK Prishtinë, me sipërfaqe prej 390m² x 3.0 = 1170m²

Nga të dhënat e mësipërme sipërfaqja totale ndërtimore do të jetë si në vijim:
A+B+C+D=27105m² +4374m²+60m²+ 1170m² =32709m²

- Bazuar në kriteret e planit rregullues, ruhet distanca në mes ndërtesave, gjegjësisht 0.5 x H sipas Planit Rregullues. Te fasadat pa ndriçim primar minimumi i distancës është 7.0m nga kufiri i parcelës;
- Etazhiteti maksimal i lejuar në Bllokun urban "F-4-1"është max. P+11, ndërsa ai propozuar sipas projektit konceptual është P+14, me aplikimin e Vendimit 01 nr. 400-660 dt. 26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2015, protokolluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efiçiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit" në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISHN), e as në kalkulimin për taksën dhe tarifën e lejes ndërtimore;
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e brendshme e bllokut e lidhur me rrugën e planifikuar të planit rregullues urban, gjegjësisht nga rruga ekzistuese, e cila rrugë lidhet me rrugën e planifikuar;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret, kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiliar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore të planifikohet një vendparkim, kurse për pjesët afariste të ndërtesës varësisht prej destinimit të parashihen vend parkimet, sipas kritereve të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim";
- Në kuadër te kompleksit të planifikohen hapësira-pika për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura - dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre të jetë me materiale bashkëkohore dhe masa të efiçiencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

**VI. Këmbimi** i pjesëve të parcelave, nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët", është S=1458m², të realizohet me pjesën e parcelës, nr. 356-1 ZK Prishtinë, të përfshirë në rrugë të planifikuar prej 1458 m², e destinuar në rrugë të planifikuar të Plani Rregullues "Prisha e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, bazuar në vlerësimin e organit kompetent.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për këmbimin e parcelave të lartë cekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ*


Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

*KosovaREF01*", punuar nga kjo drejtori dhe Manuali i këmbimit punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, dhe bazuar në vlersimin e organit kompetent, dhe e cila do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore, me kërkesë të pronarit të parcelave kadastrale, nr. 356-1 ZK Prishtinë, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

**VII. Ndarja** / parcelimi i parcelës kadastrale, nr.356-1 dhe 353-3 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban dhe bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" dhe dispozita urbanistike punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje, punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01* dhe Manualit të ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronari / investitorit, duke u bazuar në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe *"Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01"* dhe Manualit për ndarje punuar nga gjeodeti mi licencuar Faton Bajselmani nga Suhareka me numër të licencës 125. të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

**VIII. Bashkimi** i pjesëve & parcelave kadastrale, nr. 356-1, 353-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë, në pronësi private, dhe pjesës pas këmbimit të pjesëve të parcelave kadastrale nr. 353-0, 354-1 dhe 355-4 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore, pas realizimit të këmbimit të përcaktuar në paragrafin VI. të këtij vendimi, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", si dhe Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Muhaxhirët" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim.

Procedura e bashkimit do të realizohet pas realizimit të proceduarave të paragrafit VI. & VII. të vendimit të kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operatin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e Re – Zona Perëndim" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar Gëzim Halili me numër të licencës 149, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

**IX. Kyçja në infrastrukturë** - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- *Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;*
- *Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;*
- *Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;*
- *Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;*
- *Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).*

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

**X. Dokumentacioni ndërtimor** / projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi ", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e

personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- *Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;*
- *Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;*
- *Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;*
- *Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;*
- *Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;*
- *Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;*
- *Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;*
- *Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;*
- *Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;*
- *Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*
- *Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;*
- *Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;*
- *Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;*
- *Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;*

**XI. Dokumentacioni ndërtimor -** Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- *Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;*
- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;*
- *Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;*
- *Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.*

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për Leje Mjedisore Komunale hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

- *Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;*
- *Certifikatën për regjistrimin e biznesit;*
- *Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;*

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**XIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** – për parcelat kadastrale, nr. 356-1, 353-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "Arë e klasës 5", të realizohet edhe bazuar në pikën 4 të nenit 9 UA 02/2013 për zbatimin e Ligjit për Kadastër, ndryshimi i llojit të shfrytëzimit të parcelës së tokës me ligje dhe vendime të veçanta – plane urbanistike, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 & 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 & 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet - parcelës ndërtimore, sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen prej S=9035m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, duke përfshi edhe pjesët e parcelave nr. 353-0, 354-1 dhe 355-4 ZK Prishtinë, pas realizimit të këmbimit të përshkruar në paragrafin VI., në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Sipas kësaj parcela ndërtimore si tokë ndërtimore do të jetë me sipërfaqe prej S=10403m².

Kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore

**XIV. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);*
- *Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;*
- *Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;*
- *Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);*
- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);*

**XV. Pagesa e taksës** për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimit.

**XVI. Vlefshmëria** e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

## Arsyetim

Pronari / Investitori, Tafil Osmani nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02 - 0202511/18 dt.17.08.2018, ka kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa: shumëbanesore me afarizëm dhe Hoteli, me etazhitete dhe në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore, sipas projekt propozimit të prezantuar, dokumentacionit të kërkesës dhe kushteve të dokumentit të planifikimit hapësinor.

Me kërkesën për kushte ndërtimore, 05 nr. 350/02 - 0202511/18 dt.17.08.2018, fazën e trajtimit të kërkesës dhe zhvillimit të procedurave, është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale, nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë, dhe Certifikatat e njësisë kadastrale, të parcelave të lartcekura , lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e informatës nga Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" 988 dt. 22.09.2017, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;*
- *Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Tafil Osmani, nr.155372/18 dt. 29.06.2018;*
- *Incizimi gjeodezik i gjendjes ekzistuese të parcelave të trajtuara dhe rrethinës, punuar nga gjeometri i licencuar Gëzim Halili me numër të licencës 149;*
- *Projekt propozimi – "zgjidhja urbane" e kompleksit me projekt ideor, hartuar nga "Privet" L.L.C. nga, me certifikatë të regjistrimit 71162540;*
- *Fotot e lokacionit dhe ndërtesave ekzistuese;*
- *Fotokopja e dokumentit identifikues - letërnjoftimi të pronarit;*


Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës, 05 nr. 350/02 - 0202511/18 dt.17.08.2018, për caktimin e kushteve ndërtimore, dokumentacionin e prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për atë hapësirë, rregullativën ligjore në fuqi nga aspekti i planifikimit, ndërtimit & procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumentacionit të prezantuar dhe trajtuar gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, konstatoi se:

Parcelat kadastrale *nr. 356-1, 355-3 dhe 354-2 ZK Prishtinë*, përfshihen në kuadër të Bllokut urban "F-4-1", të Planit Rregullues " Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë, në kuadër të të cilës pjesë të bllokut, konkretisht pjesës veri-perëndimore të sajë shtrihen edhe nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët".

Pas analizimit të projekt propozimit të prezantuar – "zgjidhja urbane" dhe shqyrtimin të tij, në raport me kriteret e planit rregullues, është konstatuar se, edhe pse zgjidhja e propozuar me parcelat e prezantuara i plotëson kriteret e planit rregullues sipas "Treguesit ndërtimor", u konstatua se nga aspekti urban – arkitektonik, pronari ka propozuar që zgjidhja urbane e propozuar do të ishte edhe më gjithëpërfshirëse me trajtimin edhe të parcelave kadastrale nr.353-0 ZK Prishtinë, në pronësi të P.Sh. K. Komunal, si dhe nr. 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, në pronësi të PSH "Rrugët", të cilat parcela përfshihen brenda vijës rregulluese të bllokut urbanistik "F-4-1", të Planit Rregullues " Prishtina e Re – Zona Perëndim" në Prishtinë. Andaj kjo drejtori bazuar në kompetencat dhe deskrecionin që ja përcakton rregullativa ligjore në fuqi vendosi që pjesët e parcelave nr.353-0, 354-1 dhe 354-4 ZK Prishtinë, ta trajtoj përmes këmbimit sipas kërkesës së pronarit.

Kjo Drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës me dokumentacionin e bashkangjitur, me shkresën zyrtare "Informim – Plotësim dokumentacioni" 05-350/02-0202511/18 dt. 18.09.2018, është kërkuar që për vazhdimin e procedurës, lënda të plotës me dokumentacionin si në vijim:

- *Projekti konceptual të prezantohet në gjuhën zyrtare – Shqip;.*
- *Projekti konceptual duhet të plotësohet duke shtuar: pjesën tekstuale, sipërfaqet totale ndërtimore të ndërtesave (mbi tokë dhe nën tokë), shfrytzueshmëria e parcelës, etazhiteti, sipërfaqet gjelbëruese.*
- *Në bazë të projektit konceptual të prezantuar, është paraparë lidhja e ndërtesave në mes të parcelave kadastrale të cilat shtrihen në P*
- *lanin Rregullues "Kalabria" dhe Planin Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim". Projekti konceptual për këtë fazë duhet të ndryshohet duke prezantuar vetëm projektin koceptual për parcelat kadastrale të cilat shtrihen në kuadër të bllokut urbanistik "F-4-1", të tërësisë "F", të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim";*
- *Të prezantohet elaborati i incizimit gjeodezik i gjendjes faktike si dhe elaborati gjeodezik i bashkimit dhe ndarjes së parcelave kadastrale;*
- *Gjatë ndryshimit të projektit konceptual, të respektohen kriteret e Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" për të cilën jeni informuar me informatën nga Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" nr. 988 dt. 22.09.2017. lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.*
- *Të prezantohet dokumentacioni përcjellës i kompanisë dhe projektantëve;*
- *Projekti konceptual të prezantohet në formë të shtypur dhe në formë digjitale – CD (dwg), i punuar në sistemin koordinativ Kosovaref01.*

Pronari Tafil Osmani nga Gjakova, i është drejtuar kësaj drejtori me "Kërkesë për shtyrjen e afatit" 05-350/02-0202511/18/1 dt. 03.10.2018, për shtyrjen e afatit prej 15 ditëve për plotësimin e dokumentacionit. Po ashtu pronari, me shkresën zyrtare "plotësim lënde" 05-350/02-0202511/18/2 dt. 18.10.2018, duke prezantuar dokumentacionin e kërkuar nga kjo drejtori me shkresën zyrtare "Informim – Plotësim dokumentacioni" 05-350/02-0202511/18 dt. 18.09.2018.

Pas pranimin e kërkesave të lartcekura, me projekt propozimin e prezantuar dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim, Nr.04/L -110 dhe UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, me datë 22.10.2018, ka vendosë "Njoftim publik" për njoftimin dhe mundësin e dhënien së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m',dhe i cili njoftim ka qëndruar deri me datë 05.11.2018, gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në email adresat e vendosura në njoftimin publik, që nënkupton se kjo drejtori mund të vazhdoj me procedurat e caktimit të kushteve ndërtimore.

